



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.965/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë për shkak të pengimit gjatë fushatës zgjedhore, për Raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokaleve, në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Mitrovicë.

Arsyetim

Me datën 29.11.2013, subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se me datën 28.11.2013, para shtëpisë së mallrave në sheshin “ Mehë Uka “, rreth orës 10:30, subjekti politik PDK ka bërë një provokim të rëndë elektoral duke e vënë një tendë në mënyrë të kundërligjshme përballë tendës së AKR-së, si dhe sipas parashtruesit të ankesës, pas marrjes së informatave se ka grumbullime të simpatizantëve nga të dyja subjektet, Z.Agim Bahtiri, tregoi kulturën e vet qytetare dhe evropiane duke ju kërkuar simpatizantëve “të gjithë për fitore”, që të jenë të matur dhe të mos bien në provokimet të cilat i kishin përgatitur subjekti politik PDK. Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës deklaratatë të personave në cilësinë e dëshmitareve, foto, vendimin e Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, dhe Formularin e Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik.

Në deklaratën e Bajram Hajzerit anëtar i AKR-së, në Mitrovicë thuhet se kur erdhëm për aktivitete kemi qenë përballë subjektit politik PDK, lëshuan muzikë për përshëndetje, ku kjo sipas deklaruësit është e paligjshme.

Në deklaratën Fidan Mehmetit kryetar i FR- i AKR-së, në Mitrovicë, thuhet se kur erdhëm për aktivitete, kur pamë se përballë tendës subjekti politik i PDK-së, lëshojshin muzikë dhe provokojshin.

Në deklaratën e Rajmonda Muzliukaj thuhet se kur dola në aktivitetin e AKR-së, pashë tendën e subjektit politik PDK, e cila në mënyrë të kundërligjshme, kishte vendosur tendën në mënyrë provokative dhe nxitëse për ndonjë eksces mes dy subjekteve .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik më datën 29.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 30.11.2013 deri në ora 11:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK me të cilën konsideron se janë të pabaza pretendimet e AKR-së, lidhur me shkeljen e rregullave të përcaktuara në nenet e LZP-së, nenet e Kodit të Mirësjelljes, si dhe dispozitat dhe nenet e Rregullores 11/2013 të KQZ-së. Po ashtu në përgjigjen në ankesë të këtij subjekti theksohet se në respekt dhe në frymë të qartësisht ju njoftojmë se nuk kemi bërë asnjë shkelje dhe asnjë provokim ndaj asnjë subjekti gjatë fushatës tonë për raundin e dytë të zgjedhjeve, si dhe kemi lejet nga Komuna për aktivitetin tonë. Në përgjigje në ankesë theksohet edhe se janë edhe mediat ato që e kanë pasqyruar këtë aktivitet dhe në të gjitha kanalet televizive ku është dhënë kronika për fushatën në Mitrovicë, është paraqitur aktiviteti që ka kaluar pa asnjë provokim dhe në frymën e kulturës dhe bërjes së fushatës në mënyrë të qetë dhe demokratike.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se subjekti politik PDK, ka bërë një provokim elektoral duke e vendosur një tendë në mënyrë të kundërligjshme përballë tendës së AKR-së, nuk qëndrojnë sepse nga dëshmitë e ofruara nuk mund të vërtetohen pretendimet e theksuara në ankesë, se subjekti politik PDK, ka penguar gjatë mbajtjes së tubimit politik. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për të u administruar si provë relevante, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 965/2013 më datën 02.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i